REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:297929

Datë: 27.02.2020

Numri i dokumentit: 00860625

P.nr.584/2019

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, **Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin Fatos Sejdijaj dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. (M.) A. nga fshati ...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm **PP-II.nr.3583/2019 (2019:0143444) të datës 17.12.2019**, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 26.02.2020, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

- PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm **PP-II.nr.3583/2019** e **datës 17.12.2019** dhe gjykata e jepë këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

- I akuzuari **M.A,** nga babai M., i lindur me dt. ... në fshatin ...- Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ....

ËSHTË FAJTOR

- SEPSE : Më datë 04.09.2019, në shtëpinë e tij në fshatin ...-Komuna e Skenderajt, ka siguruar shërbime për të cilat e di se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe me këtë i është shmangur pagesës, në atë mënyrë që është kyçur në rrjetin elektrik përmes njehësorit elektrik nr...., edhe pse me datë 08.08.2019 i njëjti i ishte shkyçur dhe vulosur me vulën nr...., pa autorizim nga furnizuesi i autorizuar, çka është vërtetuar me rastin e kontrollit nga ana e zyrtarëve te KEDS-it.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 453 par.1, nenit 463 par.1 dhe 2, nenit 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton :

2019:297930

- D Ë N I M M E G J O B Ë -

I.- Në lartësi prej 100.00 € (njëqind euro) të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të llogaritet me 20.00 € (njëzetë euro) gjobë.

III.- Obligohet i akuzuari që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 10.00 € (dhjetë euro) si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Pala e dëmtuar Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a-KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

- A r s y e t i m -

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e saj PP-II.nr.3583/2019 datë 17.12.2019, kundër të akuzuarit M. (M.) A. nga fshati ...-Komuna Skenderaj, për shkak te veprës penale-Vjedhja e Shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së dhe në bazë të nenit 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit t'i shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhërit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPPK-së.

- Gjykata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë si : Kallëzimi penal i Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS Nr.CMS-K/DMI-... i datës 17.10.2019, Procesverbali i KEDS-it Nr.... i datës 04.09.2019, Kërkesa për plotësimin e të dhënave Nr.... e datës 07.11.2019 dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale-**Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së**, ngase i njëjti më datë 04.09.2019, në shtëpinë e tij në fshatin ...-Komuna e Skenderajt, ka siguruar shërbime për të cilat e di se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe me këtë i është shmangur pagesës, në atë mënyrë që është kyçur në rrjetin elektrik përmes njehësorit elektrik nr...., edhe pse me datë 08.08.2019 i njëjti i ishte

2019:297930

shkyçur dhe vulosur me vulën nr...., pa autorizim nga furnizuesi i autorizuar, çka është vërtetuar me rastin e kontrollit nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, për çka gjykata gjeti se i njëjti në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij akgykimi.

- Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata mori parasysh dhe vlerësosi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të njëjtin rrethanë lehtësuese gjeti, rrethanat e tij personale, ndërsa rrethanë rënduese gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, andaj duke u bazuar në rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cekura si më lartë gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke pritur me të drejtë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-së, që të parandallojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.-KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest civil.

- Nga sa u tha me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ
- Departamenti i Përgjithshëm -
P.nr.584/2019 me datë 26.02.2020.

Procesmbajtësja,
Florije Gucati

Gjyqtari i vetëm gjykues
Fatos Sejdijaj

- KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtmi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.

2019:297930